# Titulli i lëndës: HISTORI E GJUHËS SHQIPE

| Informatat themelore për lëndën | |
|---|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Filologjisë, Dega e Letërsisë Shqipe |
| Titulli i lëndës: | Histori e gjuhës shqipe |
| Niveli: | BA (Baçelor) |
| Statusi i lëndës: | Zgjedhore |
| Viti i studimeve: | Viti IV \| Semestri VII |
| Numri i orëve në javë: | 2+1 |
| Kreditë ECTS: | 4 ECTS |
| Koha / Vendi: | E mërkurë, 15:00-16:30 \| Salla 78 |
| Mësimdhënësi: | Prof. ass. dr. Shpëtim Elezi |
| Të dhënat kontaktuese: | shpetim.elezi@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës: | Historia e gjuhës shqipe është lëndë që studion gjuhën shqipe në rrafshin diakronik, duke përshkruar sistemin e kësaj gjuhe, periudhat dhe proceset e zhvillimit gjuhësor që nga kohët më të lashta e gjer më sot. Kursi është sintezë e dijeve lidhur me gjuhën shqipe dhe historinë e saj, duke i ofruar studentit kryesisht njohuri të përgjithshme e të përmbledhura mbi disa çështje themelore lidhur me sistemin e gjuhës shqipe dhe me zhvillimin e tij historik. Për trajtime më të specializuara të çështjeve, kursi e orienton studentin duke i ofruar bibliografi të përzgjedhur. |
| Qëllimet e lëndës: | Kursi Histori e gjuhës shqipe hyn ndër kurset formuese që synon t'u ofrojë studentëve të Degës së Letërsisë Shqipe njohuri gjithëpërfshirëse për historinë e gjuhës shqipe me qëllim që ata t'i thellojnë dijet e tyre në lidhje me zhvillimet diakronike të shqipes. Në të shtrohen problemet themelore të historisë së shqipes dhe jepen orientimet bazë bibliografike për këto studime. Fazat e zhvillimit të shqipes, raportet e saj me gjuhët e rajonit të pandërmjetshëm, raportet e saj me gjuhët indoevropiane, mënyra e studimit të historisë së gjuhës dhe mjetet themelore të këtij studimi zënë vend me peshë në këtë kurs. Njohja dhe familjarizimi me konceptet dhe zhvillimet themelore në këto studime është një nga synimet kryesore të kursit. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | Pas përfundimit të këtij kursi studenti: |
| | • përcakton vendin e shqipes në kuadrin e përgjithshëm historik, në mesin e familjes indoevropiane dhe në kuadër të arealit ballkanik. |
| | • identifikon konkordancat në mes të shqipes dhe gjuhëve të tjera indoevropiane dhe ballkanike. |
| | • krahason elemente të sistemit gjuhësor të shqipes me ato të gjuhëve IE dhe ballkanike. |
| | • argumenton lidhur me tezat për prejardhjen e shqipes. |

| | |
|---|---|
| | • përshkruan proceset dhe fazat e zhvillimit të historisë së shqipes, parashkrimore e shkrimore të saj.<br>• dallon elementin anas dhe të huaj në shqipen.<br>• analizon veçori të sistemit fonetik dhe morfologjik të zhvilluar në diakroni.<br>• përshkruan marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera IE dhe ballkanike.<br>• përshkruan zhvillimet konvergjente dhe divergjente brenda shqipes. |

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë / Javë | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| Ligjëratat | 2 | 15 | 22.25 |
| Ushtrime | 1 | 15 | 11.10 |
| Përgatitje për test intermediar | 3 | 4 | 12 |
| Konsultime me mësimdhënësin | 10 min | 15 | 2.5 |
| Testi, punimi i seminarit | 2 | 2 | 4 |
| Detyrë shtëpie | 1 | 15 | 15 |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgatitja për provimin final | 2 | 4 | 8 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | 2 | 2 | 4 |
| Projektet, prezantimet etj. | 1 | 1 | 1 |
| Totali | | | 111.35 orë<br>111.35:25=4.45<br>4 ECTS |

| | |
|---|---|
| Metodat e mësimdhënies: | Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike dhe ushtrimeve që ofrojnë bazën praktike në klasë si dhe me detyra të vazhdueshme në shtëpi.<br>Mësimdhënia gjatë ligjëratave do të jetë e organizuar nëpërmjet një diskutimi interaktiv për tema të caktuara. Gjatë ushtrimeve mësimdhënia është e orientuar nga studentët, ndërsa mësimdhënësi e kontrollon rrjedhën e orës dhe të shpjegimit të koncepteve të diskutueshme dhe të paqarta.<br>Studentët kanë punime seminari të kryera në mënyrë të pavarur e individuale, por bëjnë edhe punë në çifte e në grupe, si dhe përmes projekteve. |
| Metodat e vlerësimit: | Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 51%.<br>• Vijueshmëria dhe angazhimi 10%<br>• Detyrat individuale 10%<br>• Punimi i seminarit 10%<br>• Prezantimi 10%<br>• Kolokuiumi i parë 30%<br>• Kolokuiumi i dytë 30%<br>Gjithsej 100%: 51-60% (nota 6), 61-70 (7), 71-80 (8), 81-90 (9), 91-100 (10). |
| Literatura primare: | 1. Kore, Mimoza (2021). Bazat e historisë së gjuhës shqipe. Tiranë: Pegi.<br>2. Demiraj, Shaban (1989). Gjuha shqipe dhe historia e saj. Prishtinë: Rilindja.<br>3. Çabej, Eqrem (1976). Hyrje në historinë e gjuhës shqipe me fonetikë historike. Në Studime gjuhësore III. Prishtinë: Rilindja.<br>4. Ismajli, Rexhep (2021). Për historinë e gjuhës shqipe. Prishtinë: AShAK.<br>5. Ismajli, Rexhep (1987). Artikuj për gjuhën shqipe. Prishtinë: Rilindja. |
| Literatura shtesë: | 1. Ajeti, Idriz (1996-2002). Vepra 1-5. Prishtinë: ASHAK. |

| | |
|---|---|
| | 2. Barić, Henrik (1955). Hymje në historin e gjuhës shqipe. Prishtinë.<br>3. Bokshi, Besim (2008). Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike. Tiranë: ASHSH. (Botimi i parë: Prishtinë: Rilindja, 1984).<br>4. Bokshi, Besim (2010). Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes. Prishtinë: ASHAK.<br>5. Bonnet, Guillaume (1999). Les mots latins de l'albanais. Paris.<br>6. Boretzky, Norbert (1975/76). Der türkische Einfluss auf das Albanische I, II. Harrasowiz, Weisbaden.<br>7. Cimochowski, Waclaw (2004). Për gjuhën shqipe. Prishtinë: ASHAK.<br>8. Çabej, Eqrem (1976). Studime gjuhësore I-VII. Prishtinë: Rilindja.<br>9. Demiraj, Shaban (1996). Fonologjia historike e gjuhës shqipe. Tiranë: Toena.<br>10. Demiraj, Shaban (1998). Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Prishtinë: Rilindja.<br>11. Demiraj, Shaban (2004). Gjuhësi ballkanike. Tiranë.<br>12. Demiraj, Shaban (2018). EPIRI – Pellazgët, etruskët dhe shqiptarët. Prishtinë: ASHAK.<br>13. Elezi, Shpëtim (2018). Sistemi emëror i shqipes në veprën e Pjetër Bogdanit. (Disertacion doktorate). Tiranë: ASA.<br>14. Elezi, Shpëtim (2019). Sistemi përemëror i shqipes në veprën e Bogdanit. Prishtinë: ZeroPrint.<br>15. Fiedler, Wilfried (2004). Das Albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555). Prishtinë: ASHAK.<br>16. Fiedler, Wilfried (2007). Die Pluralbildung im Albanischen. Prishtinë: ASHAK.<br>17. Hamp, Eric P. (2007). Studime krahasuese për shqipen. Prishtinë: ASHAK.<br>18. Huld, Martin (1984). Basic Albanian Etymologies. Los Angeles: California State University.<br>19. Ismajli, Rexhep (2005). Gjuhë standarde dhe histori identitetesh. Tiranë: ASHSH.<br>20. Ismajli, Rexhep (2015). Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik. Prishtinë: ASHAK.<br>21. Jokl, Norbert (2014). Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip - Studien zur Albanesischen Etymologie und Wortbildung. Prishtinë: ASHAK.<br>22. Jokl, Norbert (2017). Studime historiko-krahasuese për gjuhën shqipe. Prishtinë: ASHAK.<br>23. Jokl, Norbert (2018). Gjurmime linguistike historike-kulturore në fushë të shqipes. Prishtinë: ASHAK.<br>24. Matzinger, Joachim (2006). Der Altalbanische Text E Mbsuame e Krështerë (Dottrina cristiana) des Lekë Matrënga von 1592. Eine Einführung in die albaniosche Sprachwissensschaft, Dettelbach.<br>25. Miklošič, Franc (2007). Gjurmime shqiptare - Albanische Forschungen, Prishtinë: ASHAK.<br>26. Omari, Anila (2012). Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe. Tiranë: QSA.<br>27. Orel, Vladimir (2000). A Concise Historical Grammar of the Albanian Language. Leiden/Boston/Koeln.<br>28. Pedersen, Holger (2003). Studime për gjuhën shqipe. Prishtinë: ASHAK.<br>29. Pellegrini, Giovan Battista (1998). Avviamento alla lingustika albanese. Cosenza.<br>30. Topalli, Kolec (2007). Fonetika historike e shqipes. Tiranë: QSA.<br>31. Topalli, Kolec (2011). Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Tiranë: QSA.<br>32. Topalli, Kolec (2017). Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe. Tiranë: QSA. |
| **Hartimi i planit mësimor** | |

| Java | Titulli i ligjëratës |
| --- | --- |
| Java 1: | PIE, IE dhe gjuhësia krahasimtare; Shqipja si gjuhë indoevropiane<br>Literatura: Kore 2001; Demiraj 1989; Ismajli 1987; Çabej 1976; Huld 1984: Matzinger 2006 dhe literatura plotësuese në klasë. |
| Java 2: | Periodizimi i historisë së shqipes<br>Literatura: Kore 2001; Demiraj 1989; Matzinger 2006; Bokshi 2010 dhe literatura plotësuese në klasë. |
| Java 3: | Shqipja dhe gjuhët e lashta e të sotme të Ballkanit<br>Literatura: Çabej 1976; Demiraj 1989, 2004; Ismajli 1987, 2005, 2015; Bokshi 2008; Pellegrini 1998; Matzinger 2006 dhe literatura plotësuese në klasë. |
| Java 4: | Prejardhja e gjuhës shqipe – tezat kryesore<br>Literatura: Kore 2001; Çabej 1976; Demiraj 1989; Ismajli 1987, 2021; Pellegrini 1998; Huld 1984; Matzinger 2006 dhe literatura plotësuese në klasë. |
| Java 5: | Fondi leksikor i trashëguar i gjuhës shqipe<br>Literatura: Kore 2001; Çabej 1976; Demiraj 1989; Huld 1984 dhe literatura plotësuese në klasë. |
| Java 6: | Kontaktet e shqipes me greqishten dhe huazimet greke në shqipen (të vjetrën, të mesmen dhe të renë)<br>Literatura: Kore 2001; Çabej 1976; Demiraj 1989; Pellegrini 1998; Matzinger 2006 dhe literatura plotësuese në klasë. |
| Java 7: | Kontaktet e shqipes me latinishten dhe me gjuhët romane. Huazimet latine dhe huazimet romane në shqipen (KOLOKUIUMI 1)<br>Literatura: Kore 2001; Çabej 1976; Demiraj 1989; Ismajli 1987; Pellegrini 1998; Matzinger 2006; Bonnet 1999 dhe literatura plotësuese në klasë. |
| Java 8: | Kontaktet e shqipes me sllavishten dhe huazimet sllave të shqipes<br>Literatura: Kore 2001; Çabej 1976; Demiraj 1989; Ismajli 1987, 2015; Omari 2012 dhe literatura plotësuese në klasë. |
| Java 9: | Kontaktet e shqipes me turqishten dhe huazimet turke e orientale të shqipes<br>Literatura: Kore 2001; Çabej 1976; Demiraj 1989; Ismajli 1987; Boretzky 1976 dhe literatura plotësuese në klasë. |
| Java 10: | Shqipja dhe rumanishtja<br>Literatura: Kore 2001; Çabej 1976; Demiraj 1989; Ismajli 1987, 2005, 2015; Matzinger 2006; Pellegrini 1998 dhe literatura plotësuese në klasë. |
| Java 11: | Ndarja dialektore e gjuhës shqipe dhe historiku i saj<br>Literatura: Çabej 1976; Demiraj 1989; Ismajli 1987 dhe literatura plotësuese në klasë. |
| Java 12: | Historia e shqipes së shkruar<br>Literatura: Kore 2001; Çabej 1976, 1989; Demiraj 1989; Ismajli 2005 dhe literatura plotësuese në klasë. |
| Java 13: | Historia e shqipes standarde<br>Literatura: Çabej 1976, 1989; Demiraj 1989; Ismajli 2005 dhe literatura plotësuese në klasë. |
| Java 14: | Fonetika historike e shqipes: sistemet fonematike dhe kronologjitë e tyre<br>Literatura: Çabej 1976; Ismajli 1987; Topalli 2007; Demiraj 1996; Huld 1984; Matzinger 2006 dhe literatura plotësuese në klasë |
| Java 15: | Morfologjia historike e shqipes (PREZANTIMET; KOLOKUIUMI 2)<br>Literatura: Demiraj 1988; Topalli 2011; Bokshi 2010 dhe literatura plotësuese në klasë. |

**Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk lejohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme në përputhje me masave disiplinore që parashihen në rregulloret e UP-së. Sjellja e mësimdhënësit dhe e studentëve bazohet në kodin e mirësjelljes dhe të etikës në kuadër të UP-së.